



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2331/12 prot.

Datë 23.11.2023

V E N D I M
Nr. 1229/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*ITE GROUP*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë*”, me Nr. REF-74538-07-07-2023 me objekt: “Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,582,178.34 Euro, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Ankimues:** BOE “INPLY” sh.p.k NUIS L51503032Q & “LUAR Bros” sh.p.k NUIS L72322004M dhe adresë: Kashar, Yzberisht, Kompleksi Dilo, Hyrja 3, Apartamenti 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “ITE Group” SHPK me NIPT K11323001H dhe adresë: Autostrada Tiranë Durrës, km 5, Rruga Industriale Laknas 1001

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.07.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-74538-07-07-2023 me objekt: “Loti

2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,582,178.34 Euro, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 10.08.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 13.09.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“OE “ITE GROUP” sh.p.k	82,010,400 lekë pa tvsh	kualifikuar
2-BOE “INPLY” sh.p.k & “LUAR Bros” sh.p.k	83,333,320 lekë pa tvsh	kualifikuar
3-OE “VIBTIS” sh.p.k	99,832,800 lekë pa tvsh	kualifikuar
4-OE “BAULED” sh.p.k	100,000,000 lekë pa tvsh.	kualifikuar
5-OE “HTM” sh.p.k	113,502,200 lekë pa tvsh	kualifikuar
6-OE “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k	124,980,100 lekë pa tvsh	kualifikuar
7-OE “LIQENI VII” sh.p.k	106,666,666 lekë pa tvsh	skualifikuar
8-BOE “NDERTUESI 2014” sh.p.k & “PREKA” sh.p.k	118,606,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
9-OE “Z D R A V A” sh.p.k	122,005,000 lekë pa tvsh.	Skualifikuar
10-OE “CURRI” sh.p.k	141,219,000 lekë pa tvsh.	Skualifikuar
11- OE “ALEN – CO” sh.p.k	nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike.	Skualifikuar

II.4. Në datën 19.09.2023, është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 22.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr.2331 prot., e BOE “INPLY” SHPK & “Luar Bross” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK si më poshtë vijon:

“[...] Operatori ekonomik “ITE Group” SHPK njëjtë si shoqëria jonë është në kufirin e ofertave të cilësuar anomalisht të ulëta dhe rrjedhimisht për tu kualifikuar duhet të japë shpjegimet/detajet e nevojshme në bazë të të cilave është përlllogaritur vlera dhe shërbimi i ofertuar të cilat e bëjnë ofertën e vlefshme bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Dyshojmë që ky operator nuk e ka justifikuar në mënyrën e duhur ofertën e tij në të 4 pikat e kërkuara dhe kërkojmë nga ana juaj të verifikohet argumentimi i paraqitur nga ky subjekt.

“[...] Lidhur me paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në DST e procedurës është shprehur qartë se: “Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike”

Kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojë mënyrën e plotësimit dhe gjendjen e deklaruar nga operatori ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur nga ky subjekt për këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu kërkojmë të verifikohen mjetet e deklaruara në tabelën e deklarimit të mjeteve të dorëzuara përpara shpalljes fitues. Mjetet e deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të jenë të njëjta me ato të dorëzuara para shpalljes fitues, gjithashtu operatori duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin e mëposhtëm ashtu siç parashikohet në kriterin 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim:

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit – certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.*

3. Në pikën 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojnë nëse ky operator ekonomik ka paraqitur të tre kopjet e bilanceve të certifikuara të viteve (2020,2021,2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore si dhe nëse këto bilance janë të shoqëruara me raportet e auditimit ligjor të kryera nga auditues ligjor ose shoqëri audituese.

Nga verifikimet tona në faqen e internetit ku pasqyrohen të dhëna mbi operatorë ekonomikë rezulton se ky operator nuk e ka të afishuar bilancin e vitit 2022. Si rrjedhojë ngremë dyshimet tona nëse ky operator e ka të certifikuar nga organet tatimore dhe të audituar nga ekspertë kontabël bilancin e vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme.

4. Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik është kërkuar;

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*

“[...]Kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojë nëse ky operator ekonomik ka paraqitur vërtetime për furnizime të mëparshme të lëshuara nga ente publike për përmbushjen me sukses të kontratës/kontratave dhe/ose faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen, datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Ngremë dyshimet tona se ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të kësaj procedure prokurimi pasi besojmë se nuk ka paraqitur fatura të mjaftueshme me subjekte private dhe/ose nuk ka paraqitur vërtetimet nga entet publike për realizimin me sukses të furnizimeve të ngjashme.

Në këto kushte shoqëria jonë kërkon:

- 1. Skualifikimin/refuzimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “ITE GROUP” shpk për procedurën e prokurimit“**Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II”**,*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2331/2 prot., datë 25.09.2023, lidhur me kriteret e kualifikimit për të cilat BOE “INPLY”

SHPK & “Luar Bross” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK.

II.7. Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 2331/3 prot., datë 06.10.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, Fondit Shqiptar të Zhvillimit të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8 Me shkresën me datë 11.10.2023, me lëndë “Kthim përgjigje për shkresën me nr. 3105/1 dt 26.09.2023”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2331/4 prot., datë 11.10.2023 drejtuar autoritetit kontraktor Fondit Shqiptar të Zhvillimi dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Inply” SHPK na informon se:

“[...]Njoftimi i klasifikimit për këtë procedurë është bërë në datën 13.09.2023 dhe publikimi i njoftimit të fituesit “ITE Group” SHPK është bërë në datën 19.09.2023 ku dhe fillojnë dhe afatet e ankimit sipas përcaktimeve të Kreut XIV, Ankimi Administrativ, në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, afatet e ankimit ku parashikohet se: “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit paraqesin ankesën.. Ankesa jonë është paraqitur dhe administruar në datën 22.09.2023 pranë autoritetit tuaj dhe pranë Komisionit të prokurimit Publik me nr. 2331 protokoll.

Në shkresën tuaj të datës 26.09.2023 me nr. 3501/1 prot., ju keni cituar se ankesa e paraqitur nga shoqëria jonë nuk është e vlefshme për arsye se nuk është paraqitur njëkohësisht në AK dhe KPP ashtu siç e parashikon Neni 111 i LPP, duhet të kishit verifikuar në sistemin elektronik të KPP për paraqitjen dhe konfirmimin e kësaj ankese pasi nga verifikimet e bëra nga shoqëria jonë kjo ankesë është pasqyruar që prej datës 22.09.2023.

*Nisur nga fakti që ju si AK për këtë procedurë në datën 03.10.2023 keni publikuar shtojcën 13 “Formulari i Njoftimeve të Operatorëve Ekonomikë të Sukseshëm në marrëveshjen kuadër” (në përfundim të afateve të ankimit) kur ndërkohë për këtë procedurë ekziston një ankim në proces për të cilin janë zbatuar të gjitha ligjet dhe rregullat e paraqitjes dhe pagesës dhe afateve, ne **ju sugjerojmë që të mos veproni më tej me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues pasi jeni në kundërshtim të plotë me ligjin.***

Ashtu siç përcakton dhe shkresa me nr. 2331/3 dt 6.10.2023 e KPP jeni të lutur të dërgoni informacionet lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi drejt KPP në mënyrë që kjo e fundit të vazhdojë me procedurat e vlerësimit të ankesës siç e përcakton ligji”.

II.9 Me shkresën me nr.3105/3 prot., datë 10.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2331/5 prot., datë 13.10.2023 me lëndë “Informacion lidhur me ankesën e aoperatorit “Inply” shpk

me NUIS L51503032Q”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit na informon se: “[...] Operatori “INPLY” shpk NUIS L51503032Q ka dorëzuar ankesën datë 22.09.2023 me objekt “Kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e Lotit 2 “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët-materiale elektrike lëndë e parë Faza II”, numri i referencës REF-74538-07-07-2023”.

Në zbatim të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). Rregullat e posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit.

Referuar në nenin 112, në pikën 1 të ligjit 162/2020 parashikohet: “Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni.

Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme”.

Nga verifikimi në sistemin elektronik të ankesave në KPP, autoriteti ka konstatuar se ankesa e dërguar pranë FSHZH-së nuk është publikuar në databazën e KPP, rrjedhimisht ankesa e këtij operatori ekonomik është refuzuar si e pavlefshme. Ndërkohë, për këtë ankesë, nuk kemi patur asnjë informacion nga emaili zyrtar kpp_info@kpp.gov.al sikurse autoriteti juaj na ka informuar për ankesat e tjera të publikuara në databazën e ankesave. Aktualisht ankesa e operatorit në fjalë nuk rezulton të jetë publikuar në KPP as sot më datë 10.10.2023.

Me shkresën nr. 3105/1 prot. Datë 26.09.2023 me lëndë “Kthim përgjigje ankimit datë 22.09.2023” FSHZH i ka kthyer përgjigje ankimesit. Shkresa është dërguar në rrugë postare në adresën e deklaruar nga ankimesi në formularin e ankesës. Zarfë me shkresën zyrtare është kthyer nga zyra postare, me arsyen adresë “e panjohur”.

Në këto kushte më datë 29.09.2023 autoriteti kontraktor i ka komunikuar ankimesit me emailin zyrtar prokurime@albaniandf.org, shkresën nr. 3105/1 prot., datë 26.09.2023 me lëndë “Kthim përgjigje ankimit datë 22.09.2023” në adresën e emailit të deklaruar bë formulimin e ankesës info@inply.al. [...]”.

II.10. Me shkresën nr nr. 2331/6 prot. datë 24.10.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe për dijeni operatorit ekonomik “Inply” SHPK dhe operatorit ekonomik “ITE Group” SHPK si vijon:

“[...]Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “INPLY” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj, nga operatori ekonomik “ITE GROUP”

SHPK, lidhur me mjetet e deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në përmbushje të pikës 2.3.3 “Shtojca 7”, të kriterëve të vecanta për kualifikim, pas publikimit të njoftimit të fituesit, për këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 4 të nenit 82 të Vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë KPP-së kërkesën për sqarime mbi ofertën anomalisht të ulët drejtuar operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik[...].”

II.11. Me shkresën nr. 3105/6 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2331/7 prot., datë 31.10.2023 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “[...] Dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria “ITE Group” shpk mbi disponimin e mjeteve si më poshtë:

- Kontratë qiraje nr. repertori 441, nr. koleksioni 216, datë 13.04.2022, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Tiranë, gjithsej 24 fletë.
- Kontratë qiraje nr. repertori 1490, nr. koleksioni 358, datë 03.08.2023, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Tiranë, gjithsej 16 fletë.
- Kontratë qiraje nr. repertori 1489, nr. koleksioni 357, datë 03.08.2023, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega vendore Tiranë, gjithsej 17 fletë.

ii. Kërkesë për sqarim lidhur me ofertën anomalisht të ulët datë 11.09.2023 dhe print screen të kërkesës elektronike të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, drejtuar shoqërisë “ITE GROUP” shpk për dhënien shpjegim për ofertën anomalisht të ulët, gjithsej 2 fletë.

iii. Shkresa “Kthim përgjigje datë 13.09.2023 e shoqërisë “ITE Group” shpk mbi argumentimin e ofertës ekonomike anomalisht të ulët, protokolluar pranë FSHZH me nr. 3019 prot., datë 13.09.2023 gjithsej 37 fletë (kthimi i përgjigjes është dorëzuar dhe në SPE).

Në lidhje me procedurën në fjalë dhe në vijim të shkresës tonë nr. 3105/3 prot., datë 10.10.2023 ju bëjmë me dije se autoriteti pasi ka refuzuar ankimin e shoqërisë “Inply” SHPK si të papublikuar në databazën e të dhënave të KPP-së në llogarinë e autoritetit kontraktor FSHZH në bazë të ligjit ka vijuar me publikimin e njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit dhe me lidhjen e marrëveshjes kuadër. Sjellim në vëmendje se aktualisht formulari i publikimit të ankimit online, nuk rezulton i publikuar në databazën e KPP të FSHZH, regjistruar si autoritet kontraktor për shqyrtimin e ankesave online, (printscreen dt 26.10.2023 e portalit ankesa në shqyrtim)”. ”

II.12. Me shkresën datë 31.10.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2331/8 prot., 01.11.2023, me lëndë “Në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 2331/2023 prot., datë 22.09.2023”, operatori ekonomik “INPLY” SHPK citon si vijon: “[...]Së pari, autoriteti kontraktor ka shpallur fitues paraprak një OE i cili nuk përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit ashtu siç janë cituar dhe në formularin tonë të ankesës datë 22.09.2023 të paraqitur pranë AK dhe pranë KPP siç eparashikon ligji.

Së dyti, autoriteti kontraktor dhe pse njihet në mënyrë shkresore me një ankesë zyrtare të shoqëruar me mandat pagesë siç e parashikon ligji, vendos të mos e pezullojë procedurën dhe të mos marrë në konsideratë këtë ankesë duke vazhduar normalisht me shpalljen fitues të OE të renditur i pari.

Së treti, autoriteti kontraktor dhe pse procedura në fjalë ka qënë në proces ankimi, ka vijuar me shpalljen fitues përfundimtar këtë OE në datën 3.10.2023 kur ende nuk ishte marrë një vendim mbi shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga ana jonë pranë AK dhe KPP.

Si autoriteti më i lartë ligjzbatues në fushën e prokurimeve publike kërkojmë të verifikoni në mënyrë të drejtë dokumentacionin e paraqitur nga ana e OE i renditur i pari ITE Group si dhe të verifikoni nëse ky OE ka tentuar të rregullojë gabimet e dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve me anë të paraqitjes së tyre në formë fizike përpara shpalljes fitues paraprak[...].

II.13. Me shkresën datë 31.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2331/9 prot., datë 03.11.2023 me lëndë “Argumentat e operatorëve ekonomik “Ite Group” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë me nr. REF-75438-07-07-2023 me objekt “Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përsbaskët – materiale elektrike lëndë e parë Faza 2”, operatori ekonomik i interesuar “ITE Group” SHPK ka paraqitur argumente mbi pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues.

II.14. Me shkresën me nr. 2331/10 prot. datë 21.11.2023 Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion” i është drejtuar autoritetit kontraktor Fondit Shqiptar të Zhvillimit si vijon: “[...]Me shkresën nr. 3105/6 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2331/7 prot., datë 31.10.2023 ju keni vënë në dispozicion “[...]Dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria “ITE GROUP” SHPK mbi disponimin e mjeteve si më poshtë:

- Kontratë Qiraje nr. repertori 441, nr. koleksioni 216, datë 13.04.2022, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Tiranë, gjithsej 24 fletë
- Kontratë Qiraje nr. repertori 1490, nr. koleksioni 358, datë 03.08.2022, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Tiranë, gjithsej 16 fletë
- Kontratë Qiraje nr. repertori 1489, nr. koleksioni 357, datë 03.08.2022, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore Tiranë, gjithsej 17 fletë [...].

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur shkresës me nr. 3105/6 prot., datë 27.10.2023 Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, mospërputhje ndërmjet numrit të faqeve të deklaruar nga ju dhe dokumentacionit të dorëzuar.

Sa më sipër, lutem konfirmoni nëse dokumentacioni i dorëzuar nga ana juaj është i plotë dhe përfundimtar. Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion informacion nëse

është mbajtur procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit”.

II.15 Me shkresën me nr. 3105/8 prot., datë 21.11.2023, protokolluar me nr. 2331/11 prot., datë 21.11.2023 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit na informon se: “[...] po ju vëmë në dispozicion dokumentacionin e plotë të dorëzuar nga shoqëria “ITE Group” SHPK sipas procesverbalit datë 18.09.2023, “Mbi verifikimin dhe marrjen në dorëzim të dokumenteve të dorëzuar nga operatori fitues “ITE GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, Marrëveshje kuadër, “Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II », me Nr. REF-74538-07-07-2023.

Bashkëlidhur lutem do të gjeni procesverbalin e Komisionit datë 18.09.2023 dhe dokumentacionin e plotë për shoqërinë “ITE GROUP” SHPK [...]”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “INPLY” SHPK & “Luar Bross” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ITE Group” SHPK me argumentin, se “[...]Operatori ekonomik ITE GROUP SHPK njëjtë si shoqëria jonë është në kufirin e ofertave të cilësuarat anomalisht të ulëta dhe rrjedhimisht për tu kualifikuar duhet të japë shpjegimet/detajet e nevojshme në bazë të së cilave është përlllogaritur vlera dhe shërbimi i ofertuar të cilat e bëjnë ofertën e vlefshme bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Dyshojmë se ky operator nuk e ka justifikuar në mënyrën e duhur ofertën e tij në të 4 pikat e kërkuara dhe kërkojmë nga ana juaj të verifikohet argumentimi i paraqitur nga ky subjekt”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, parashikohet si më poshtë vijon:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
------------	--

III.1.2. Në shtojcën 5 “ Formulari i specifikimeve teknike” të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SIPAS SPECIFIKIMEVE B/LIDHUR DST PER KATR LOTE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

I.Specifikime teknike (Materiale Elektrike)

Materiale Elektrike

F. Tub metalik D=140mm (per intersektim rruge)

Tubat metalik duhet të jenë pa tegel saldimi dhe të jenë të zinguar, prodhime të standartizuara

sipas normave europiane

F.V.tubo plastike

Tub korrugato prej polietileni PEHD me dopio shtresë për mbrojtjen e kablllove të instalimeve elektrike dhe telefonike nëntokësore. I përbërë prej dy elementëve, i jashtëmi i rrudhosur dhe i brendëshmi i lëmuar. I stabilizuar kundrejt rrezatimeve UV. Konform normave EN 61356-1:2009, EN 61356-24:2011. I pajisur me xhuno polietileni dhe guarnicion gome.

Ngjyra RAL 70305

Temperatura e punës (- 10 / + 60) °C

Rrezja e kthimit 8x diametri

Rezistenca kundrejt shtypjes 450N (EN 50086-2-4)

F shtylla metalike per ndriçim

Shtyllat e ndriçimit duhet të jenë çelik i galvanizuar. Shtylla e ndriçimit duhet të jetë e përshtatshme për tu instaluar referuar detajeve përkatëse. Baza dhe pjesa e sipërme e shtyllës duhet të jenë të hapura për të lejuar kalimin e kabullit dhe instalimin elektrik. Të dhënat teknike të shtyllave të ndriçimit janë si më poshtë:

- Gjatësia totale 4.5 metër, 7 metër dhe 9 metër

Shtylla e ndriçimit duhet të:

Mbajë ngarkesat e projektimit

Të jetë rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe korrozionit

Ofrojë hapësirë të mjaftueshme për lidhjet elektrike dhe instalimin e ndriçuesit

Te minimizojë mirëmbajtjen

F. krah per shtylla metalike per ndriçim

Krahu për shtylla ndriçimi duhet të jetë i ndërtuar me të njëjtin material të shtyllave (çelik i galvanizuar). Dimensioni i tyre duhet të jetë 1 me 1.5 metra dhe gjerësi të përshtatshme për inkastrim tek shtyllat metalike. Kendi i brendshëm duhet të jetë 10-15°. Ato duhet të jenë të pajisura me aksesorët e përshtatshëm për fiksime të tyre.

F. Morseteri shtyllë 3P+sig.8a+ kapak

Materiali i kutisë mbajtëse prej poliamidi vetëshuarës V2, ngjyrë natyrale. Baza izoluese e stampuar me poliamid vetëshuarës me ngjyrë natyrale. Morseteri per bronzi 58 me 3 drejtime. Baza dhe mbulesa e derdhur në rrëshirë poliamide të përforcuar me fibra xhami VO vetë-shuarëse (UL-94). Vida celik ioksi 304. Tension nominal 450V, rrymë maksimale 63A. Mbatëse siguresash për sikuresa fishek dim 8,5x31,5 – 380 V - max 10 A. Darë për mbërthim siguresë me bronzi 58 me sustë elastike.

Kutia mbajtëse me izolim II.

Perimetri i pakapkut me IP43

Hyrja e kablllove IP23B (sipas EN 60529)

Rezistenca ndaj goditjeve IK 088 (sipas EN 62262)

F. Ndricues led 100-130Ë, 120 lm/ëat, IP 66, 4000-6400K (per rruge dhe sheshe)

Fuqia	100-130Ë, Led
Fluksi	12000 - 15600 lm
Tensioni i punës	220 - 240 V
Frekuenca e punës	50 - 60 Hz
Lloji i ndriçimit	4000 - 6500 K
Klasa e energjisë (EEC)	A++
Efiçenca e ndriçuesit	120lm/Ë
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Shkalla e mbrojtjes mekanike	IK07
Jetëgjatësia (L80)	>50 000 orë
Temperatura e punës	-40 °C – +50 °C
Indeksi i vlerësimit të ngjyrave (CRI) [Ra]	>80
Certifikimet	CE
Garancia	5 vjet

F. Ndricues konik led 30-50Ë, 50 lm/ëat, IP 66, 4000-6400K (per rrugica dhe parqe)

Fuqia	30-50Ë, Led
Fluksi	1500 - 2500 lm
Tensioni i punës	220 - 240 V
Frekuenca e punës	50 - 60 Hz
Lloji i ndriçimit	4000 - 6500 K
Klasa e energjisë (EEC)	A++
Efiçenca e ndriçuesit	50lm/Ë
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Shkalla e mbrojtjes mekanike	IK07
Jetëgjatësia (L80)	>50 000 orë
Temperatura e punës	-40 °C – +50 °C
Indeksi i vlerësimit të ngjyrave (CRI) [Ra]	>80
Certifikimet	CE
Garancia	5 vjet

F. pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086

Pusetë me material polipropilen me rezistencë të lartë kundrent sforcimeve mekanike. Rezistent kundrejt agjentëve kimik dhe atmosferik. Me dimensione 40x40x40, i pajisur me kapak dhe guarnicion gome. Puseta duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë që të lejojë hapjen e vrimave për futjen e tubave pa e shkatërruar atë.

F. elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm

Specifikimet teknike, elektroda kryq FeZn

Elektrodë në formë plusi, çelik i galvanizuar në të nxehtë me seksion 50X 50X3 mm, gjatësi 1500 mm, 5.4 kg , për tu futur në tokë. E përbërë nga një piastër në formë flamuri me tre vrima për lidhjen e përcjellësit, shiritit apo aksesorëve të ndryshëm.

TE DHENAT TEKNIKE

- Formë kryqi “+” jo më pak se 50x3mm, H=1.5 m
- Cilësia e çelikut DIN 17 100
- Pajisur me pllakë bashkuese
- Paisur me morseten për bashkimin me përcjellësin me diametër deri 13mm
- i përputhshëm me DIN 48 – 452
- Shtresë zinku – minimumi 70 mikron
- Kapikordat prodhohen në përputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre.

F. kuader komandimi komplet me santeri + fotoelement

Të përgjithshme

Panelet e shpërndarjes do të jenë sipas standardit IEC (pjesët e kontrollit dhe të kyçje-çkyçjes për tension të ulët), në përputhje me standartet përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare. Panelet e shpërndarjes do të normohen për tension alternativ 400 V dhe normimi i rrymës sipas ngarkesës së lidhur duke përfshirë ngarkesën rezervë 30 %. Projektimi dhe ndërtimi i paneleve do të jetë i tipit shpërndarës për ambiente të brendshme dhe i montueshëm në mur/dysheme dhe të jetë me përmasa, normim dhe vendosje në përputhje me specifikimet teknike, skemën njëfillëshe dhe të prodhohet në përputhje me standartet. Çdo panel do të jetë i pajisur me lidhje të fortë dhe të lëvizshme neutrale për izolim dhe një zbarë për bashkimin e përcjellësve të tokës.

Plan-vendosja e pajisjeve brenda panelit do të jetë e tillë që të jenë të arritshme të gjitha pjesët, kabllot hyrëse dhe dalje dhe bashkuesi i tubave të kabllave.

Paneli do të jetë i pajisur me terminale të mbrojtura nga futja e gishtave për të gjithë lidhjet e hyrjes dhe të daljes. Terminalet për qarqet e sinjalit dhe kontrollit do të jenë të ndarë nga qarqet e fuqisë dhe të shënuar në mënyrë të qartë. Terminalet për sinjalet dhe komandat do të pajisen me lidhje për ndarje. Do të merren parasysh ngjyrat e mëposhtme:

- Fazat L1, L2, L3: Zezë, Kafe, Gri
- Neutri: Blu
- Toka: Jeshil/Verdhë

Në panel duhet të lihet një hapësirë rezervë për zhvillime të mëtejshme. Kjo hapësirë duhet të jetë 20 % e moduleve që janë në shfrytëzim. Vendet bosh do të pajisen me pllaka bosh. Në anën e brendshme të derës do të vendoset lista e qarqeve të emërtuara sakte që janë instaluar në panel.

Paneli elektrik dhe aksesorët e tij duhet të plotësojnë normat CEI EN 60439-1, IEC 61439-1, IEC 61439-2 dhe fraksionet e tyre. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara “CE”.

Specifikimet teknike të panelit

Në tabelën e mëposhtme jepen specifikimet teknike të panelit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara “CE”.

Karakteristikat teknike të panelit

<i>Tensioni nominal i punës</i>	230 / 400 V
<i>Frekuenca</i>	50 – 60 Hz
<i>Rryma nominale e panelit</i>	40-60A (referuar detajeve)
<i>Rryma e lidhjes së shkurtër</i>	25kA
<i>Rryma impulsive e lidhjes së shkurtër</i>	50kA
<i>Tensioni i izolimit</i>	1000 V
<i>Shkalla e mbrojtjes</i>	IP65
<i>Rezistenca mekanike IK</i>	IK08
<i>Temperatura e punës</i>	-5°C / +40°C
<i>Kushtet klimaterike (t°/RH%)</i>	+ 23°C/83% - 40°C/93%

F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar 4x10mm², 4x16mm², 4x25mm², 4x35mm²

Të përgjithshme

Të gjithë kabllot nëntokësor të fuqisë janë projektuar që të jenë të sigurtë në kushte klimatike të ndryshme pa pësuar dëmtime. Materialet duhet të jenë të sigurt edhe kur janë në ngarkesë, nën tension apo nën veprimin e lidhjes së shkurtër apo avarive të tjera që mund të ndodhin në sistem, ato duhet të sigurojnë dhe punojnë në kushte optimale. Kabllot LV nëntokësorë të fuqisë duhet të prodhohen konform standardeve IEC ose ekuivalentet e tyre.

Kërkesa të detyrueshme

Është e detyrueshme që furnizuesi të sigurojë:

Certifikatat e prodhuesit ISO 9001

Të dhëna teknike siç kërkohen në specifikimet teknike

Të gjitha testet dhe raportet e fabrikës

Skicat dhe dimensionet

Të kenë marketim CE

Kushtet e sistemit

Të dhëna për sistemin

<i>Specifikime</i>	<i>Unit</i>	<i>Sistemi 0.4 kV</i>
<i>Tensioni më i lartë i sistemit</i>	<i>kV</i>	0.66
<i>Tensioni nominal i sistemit</i>	<i>V</i>	400/230
<i>Frekuenca e sistemit</i>	<i>Hz</i>	50
<i>Numri i fazave</i>	<i>f</i>	3
<i>Sistemi i tokëzimit</i>		<i>i izoluar</i>

Kushtet atmosferike

<i>Temperatura maksimale e ambientit</i>	40 °C
<i>Temperatura minimale e ambientit</i>	-10 °C
<i>Temperatura maksimale në sipërfaqen e ekspozuar nga</i>	60 °C
<i>Lagështia relative maksimale (ajër)</i>	80 %
<i>Lartësia maksimale mbi nivelin e detit</i>	<1000 m
<i>Temperatura maksimale e ambientit</i>	40 °C

Standartet Referuese

The LV Underground poëer cable shall be manufactured açording to the folloëing IEC Standards and other equivalentents.

IEC 227 - “PVC insulated cables of rated voltages up to and including 450/750 V”.

IEC 228 - “Conductors of insulated cables”.

IEC 220 - “Impulse tests on cables and their açessories”.

IEC 724 - “Guide to the short -circuit temperature limits of electric cables ëith a rated voltages.

not exceeding 0, 6/1,0kV”.

IEC 881 - “Common test methods for insulating and sheathing materials of electric cables”.

IEC 885 - “Electrical test methods for electric cables”.

Kablloet duhet të jenë të aftë të punojnë në temperaturë të vazhdueshme pune maksimale prej 70°C dhe duhet të jenë të prodhuar për instalim direkt nën tokë, por mund të përdoren edhe në ambiente të brendshme ose në tubacione nën tokë sipas kushteve të terrenit. Përcjellësit prej alumini duhet të jenë të shkallës 99.5% pastërti të gradës elektrike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Shënime

Kablloet TU duhet të kenë shënimet të stampuara në mënyre të paheqëshme. Në kabllo duhet të jenë shënimet e mëposhtme:

- *Emri i prodhuesit*
- *Standartet referuese*
- *Shënimi qe identifikon numrin serial dhe vitin e prodhimit*
- *numri, seksioni dhe materiali i përcjellësit*
- *tensioni I izolimit(1000V)*
- *lloji i materialit izolues*
- *markim CE*

Shënimi do të ketë përmasa të mjaftueshme për tu lexuar në raport me diametrin e kablloet. Hapësira ndërmjet dy shënimeve të njëpasnjëshme nuk do t'i kalojë 50 cm.

Testet

Të gjithë testet duhet të jenë konform IEC 227, 220, 502, dhe 811.

F. kabllo elektrik FROR, 3x1.5 mm²

Kodet dhe standardet

Kabllo të përdoren për furnizimin me energji duhet të jenë në përputhje me standardet, rregullat dhe rregulloret e përmendura në Specifikimet e Përgjithshme, veçanërisht në përputhje me standardet e mëposhtme:

- IEC 60076
- IEC 60354
- IEC 60502-1
- EN 50575:2014
- EN 50575/A1:2016

Specifikimet teknike të kabllave

Kabujt e furnizimit me energji elektrike si dhe kabujt e komandimit, duhet të jenë të përshtatshëm si për instalime të brendshme dhe të jashtme. Kabujt janë të tipit FROR, me Përcjellës fleksibël prej bakri të kuq të klasës 5, me izolim PVC të cilësisë TI2 të mbështjellë me PVC cilësia TM2.

Gjatë instalimit duhet të kihet parasysh që rrezja e kubaturës të jetë $R_k=4XD$.

Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE".

Karakteristikat teknike të kabllave FROR

Tensioni nominal Uo/U	450V/700 (AC)
Tensioni i provës	2500 V
Temperatura maksimale e ushtruar	70°C
Temperatura minimale e ushtruar	-15°C
Rrezja e rekomanduar minimale e kthimit	4 herë sa diametri i
Materiali veshës	PVC

F. përcjellës CU të izoluar me gome, për tokëzim, seksion 16.0 mm²

Kabell fleksibël, me përberje nga polyvinyl chloride termoplastik, dhe me përcjellës bakri të kuq të klasës 5, shkalla e izolimit normale. I aplikueshem për instalime elektrike të brendshme dhe të jashtme dhe rezistent ndaj temperaturave. I prodhuar në ngjyrat standarte verdhe jeshile.

- Tipi: Përcjellës elektrike
- Materiali i izolimit: PVCR2
- Temperatura e punës: +5°C - +60° C on the conductor
- Tensioni: N07VK-K 240V

Zerat e Materialeve:

- F. tub Ø 200 mm (për inkastrimin e shtyllave)
- F. Tub metalik D=140mm (për intersektim rrugë)
- F.V.tubo plastike Ø 63
- F. tuba plastmasi Ø 80
- F shtylla metalike për ndriçim, H=4.5m
- F. shtylla metalike për ndriçim, H=7m
- F. shtylla metalike ndricimi H=9m
- F. krah dy degësh për shtylla metalike për ndricim

- *F. krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10*
- *F. Morseteri shtylle 3P+sig.8a+ kapak*
- *F. Ndricues led 100-130Ë, 120 lm/ëat, IP 66, 4000-6400K (per rruge dhe sheshe)*
- *F. elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm*
- *F. kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement*
- *F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm²*
- *F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x16mm²*
- *F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm²*
- *F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x35mm²*
- *F. kablllo elektrik FROR, 3x1.5 mm²*
- *F. percjellesa CU te izoluar me gome, per tokezim, seksion 16.0 mm²*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 7 m*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 8 m*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 9 m*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 10 m*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 11 m*
- *Shtylle centrifugale b/a L = 12 m*

III.1.3 Në dokumentet e tenderit në preventivin bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka kërkuar:

Nr	Emertimi i Materialeve	NJESIA	Sasite Totale	Çmimi	Vleftha
II - Materiale elektrike					
1	F. tub Ø 200 mm (per inkastrimin e shtyllave)	m	1,700		
2	F. Tub metalik D=140mm (per intersektim rruge)	m	200		
3	F.V.tubo plastike Ø 63	m	16,000		
4	F. tuba plastmasi Ø 80	m	16,000		
5	F shtylla metalike per ndricim, H=4.5m	cope	700		
6	F. shtylla metalike per ndricim, H=7m	cope	700		
7	F. shtylla metalike ndricimi H=9m	cope	500		
8	F. krah dy degesh per shtylla metalike per ndricim	cope	500		
9	F. krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	cope	700		
10	F. Morseteri shtyllë 3P+sig.8a+ kapak	cope	1,700		
11	F. Ndricues led 100-130W, 120 lm/wat, IP 66, 4000-6400K	cope	1,700		
12	F. Ndricues konik led 30-50W, 50 lm/wat, IP 66, 4000-6400K	cope	700		
13	F. pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	cope	1,900		
14	F. elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm	cope	1,900		
15	F. kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	cope	100		
16	F.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese	m	13,000		
17	F.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese	m	12,800		
18	F.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese	m	12,800		
19	F.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese	m	5,020		
20	F. kablo elektrik FROR, 3x1.5 mm ²	m	9,500		
21	F. percjellese CU te izoluar me gome, per tokezim, seksion 16.0 mm ²	km	4		
Lot 2 (Fondi Limit) pa TVSH			Materiale elektrike		
Lot 2 (Fondi Limit) me TVSH			Materiale elektrike		

III.1.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 2331/7 prot., datë 31.10.2023, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “ITE GROUP” SHPK është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO i është drejtuar operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK me kërkesë për sqarim për oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.5. Në përgjigje të kërkesës së KVO, me shkresën datë 13.09.2023 me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 3019 prot., datë 13.09.2023, operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka argumentuar si më poshtë:

“ [...]ITE Group shpk e krijuar në vitin 1995 është kompani lider në sektorin e materialeve elektrike për tregun e Shqipërisë. Gjatë këtyre 28- viteve, si kompani kemi arritur të marrim pjesë në furnizimin me materiale elektrike në disa projekte publike nga më të rëndësishmet kohët e fundit në Shqipëri siç janë:

1. Sheshi Skëndërbej
2. Teatri Operas dhe Baletit
3. Bulevardi Zogu i parë
4. Parku Olimpik i Tiranës
5. Stadiumi Loro Boriçi Shkodër
6. Stadiumi Elbasanit
7. Ndriçimi i Sautostradës në segmentin Tiranë-Rinas

Ekspertiza, profesionalizmi dhe eksperiencia e krijuar gjatë këtyre viteve ka bërë që të kemi bashkëpunim me disa nga branded më prestigjoze në sektorin elektrik ku vlen të përmendim Philips (signify), Schneider Electric, Bosch, Prysmian Group etj.

Ndërkohë bazuar në ofertën tonë të datës 10.08.2023 dhe duke marrë parasysh se ITE Group shpk ka marrëdhënie bashkëpunimi të drejtpërdrejta me prodhues të materialeve elektrike, në këto kushte cmimet që kemi marrë nga partnerët/furnitorët tanë sipas ofertave/kuotimeve bashkëngjitur konkretisht për zërat në preventiv si më poshtë:

- F. Ndriçues led 100-130 ë, 120 lm/ëat, IP 66, 4000-6400K
- F. Në tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x10)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x16)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x35)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x25)
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=9m
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=7m
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=4.5m
- F.krah shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10
- F.Morseteri shtylle 3P+sig.8a+kapak

Të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të këtij preventivi ose 76% të tij, po ju detajojmë përlllogaritjen e çmimeve të shitjes dhe ofertat/kuotimet që kemi marrë nga prodhues direkt të këtyre materialeve.

Bashkëngjitur kësaj shkrese, operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK ka paraqitur në autoritetin kontraktor analizën e kostos për zërat e sipërpërmendur; si dhe ka paraqitur fatura tatimore blerje artikujsh të ndryshëm, si dhe autorizim distribucioni.

III.1.6. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]”

III.1.7. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.8 Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 82,010,400 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e

ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.8. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të fashikullit administrativ rezulton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertës në datë 11.09.2023 me anë të shkresës me lëndë “*Kërkesë për sqarim lidhur me ofertën anomalisht të ulët*”, i ka kërkuar operatorit ekonomik “ITE

GROUP” SHPK “...shpjegime për elementë të veçantë të ofertës...”. Me anë të shkresës datë 13.09.2023 me shkresën me lëndë “Kthim përgjigje”, operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, ka paraqitur informacion në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, nga e cila rezulton, se ky i fundit krahas sqarimit narrativ ka paraqitur dhe një analizë të detajuar të përllogaritjes së çmimeve të shitjes dhe ofertat/kuotimet që kanë marrë nga prodhuesit direkt të këtyre materialeve. Konkretisht konstatohet se operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 13.09.2023, me lëndë “Kthim përgjigje”, ku ka shpjeguar elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: “...ITE Group shpk e krijuar në vitin 1995 është kompani lider në sektorin e materialeve elektrike për tregun e Shqipërisë. Gjatë këtyre 28- viteve, si kompani kemi arritur të marrim pjesë në furnizimin me materiale elektrike në disa projekte publike nga më të rëndësishmet kohët e fundit në Shqipëri siç janë: Sheshi Skëndërbej, Teatri Operas dhe Baletit, Bulevardi Zogu i parë, Parku Olimpik i Tiranës , Stadiumi Loro Boriçi Shkodër, Stadiumi Elbasanit, Ndriçimi i Sautostradës në segmentin Tiranë-Rinas. Ekspertiza, profesionalizmi dhe eksperiencia e krijuar gjatë këtyre viteve ka bërë që të kemi bashkëpunim me disa nga branded më prestigjioze në sektorin elektrik ku vlen të përmendim Philips (signify), Schneider Electric, Bosch, Prysmian Group etj. Ndërkohë bazuar në ofertën tonë të datës 10.08.2023 dhe duke marrë parasysh se ITE Group shpk ka marrëdhënie bashkëpunimi të drejtpërdrejta me prodhues të materialeve elektrike, në këto kushte çmimet që kemi marrë nga partnerët/furnitorët tanë sipas ofertave/kuotimeve bashkëngjitur konkretisht për zërat në preventiv si më poshtë:

- F. Ndriçues led 100-130 ë, 120 lm/ëat, IP 66, 4000-6400K
- F. Në tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x10)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x16)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x35)
- F. Ne tokë kablllo AI fuqie-1000V, me izolim gome e mbulesë (4x25)
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=9m
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=7m
- F. Shtylla metalike ndriçimi H=4.5m
- F.krah shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10
- F.Morseteri shtylle 3P+sig.8a+kapak

Të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të këtij preventivi ose 76% të tij, po ju detajojmë përllogaritjen e çmimeve të shitjes dhe ofertat/kuotimet që kemi marrë nga prodhues direkt të këtyre materialeve.

Referuar pikës 1 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë”, është në diskrecion të autoritetit kontraktor që të kërkojë sqarime për të gjithë zërat e preventivit të paraqitur në

ofertë ose për ato zëra të cilat autoriteti kontraktor ka dyshime që nuk mund të përmbushen nga operatori ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK është paraqitur analiza e kostos për një pjesë të zërave në preventiv të cilat siç citon edhe operatori ekonomik përbëjnë **76 % të preventivit**, konkretisht për zërat F. Ndricues led 100-130W, 120 lm/wat, IP 66, 4000-6400K, F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese, F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese, F.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese, F. shtylla metalike ndricimi H=9m, F. shtylla metalike per ndriçim, H=7m, F shtylla metalike per ndriçim, H=4.5m, F. krah dy degesh per shtylla metalike per ndricim, F. krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10, F. Morseteri shtylle 3P+sig.8a+ kapak, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, Komisioni gjykon se referuar preventivit të zërave të ofruar, sipas parashikimeve në dokumenta e tenderit për zërat e sipërcituar është paraqitur analizë kosto e detajuar duke justifikuar listën e cmimeve të ofruara në ofertën ekonomike.

Sa më sipër, operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, ka arritur të argumentojë elementet e ofertës së tij për të cilët autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime, sic parashikohet në nenin 93 të LPP-së, si më sipër cituar, duke krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INPLY” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e BOE “INPLY” SHPK & “Luar Bross” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ITE Group” SHPK me argumentin, se: *“Në shtojcën 7, kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: a. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcë 8. Lidhur me paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në DST e procedurës është shprehur qartë se: “Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*

Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike”

Kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojë mënyrën e plotësimit dhe gjendjen e deklaruar nga operatori ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur nga ky subjekt për këtë procedurë prokurim”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këtë pretendim, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.2.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke*

verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

III.2.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK lidhur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit ankimuesi “INPLY” SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efijencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke

justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “INPLY” SHPK, për mospërbushjen nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK të shtojcës 8, Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të parashtruar në ankesë nuk merret në shqyrtim.

III.3 Lidhur me pretendimin e BOE “INPLY” SHPK & “Luar Bross” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ITE Group” SHPK me argumentin, se: “[...]Gjithashtu kërkojmë të certifikohen mjetet e deklaruara në tabelën e deklarimit të mjeteve me dokumentet e mjeteve me dokumentet e mjeteve të dorëzuara përpara shpalljes fitues. Mjetet e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit duhet të jenë të njëjta me ato të dorëzuara përpara shpalljes fitues, gjithashtu operatori duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin e mëposhtëm ashtu sic parashikohet në kriterin 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim:

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.3.1 Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, të dokumentave të tenderit përcaktohet se:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i>	<u>Punonjës</u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i> <hr/> <i>Profili i punonjësve</i> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i> <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.3.2 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 “kapaciteti teknik” përcaktohet se:

2.3.3 Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
<i>1</i>	<i>Kamion me vinç</i>	<i>4</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.3.3 Në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit
- Kontratë qiraje nr. repertori ***, nr. koleksioni ***, datë 13.04.2023 + dokumentacionin bashkëlidhur
- Kontratë Qiraje nr. repertori ***, nr. koleksioni ***, datë 03.08.2023+ dokumentacionin bashkëlidhur
- Kontratë qiraje nr. repertori ***, nr. koleksioni ***, datë 03.08.2023+dokumentacionin bashkëlidhur

III.3.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...*”

III.3.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime."

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.7. Konkretisht, referuar kriterit në lidhje me disponimin e mjeteve, të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, këto kërkesa do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik ka deklaruar se ka në dispozicion mjetet automjet për përdorim të veçantë (kamion me vinç) me targë AB[***], me qera, mjetin me targë kamion me vinç për transport malli, AB[***], me qera, mjetin kamion me vinç për transport malli AB[***] me qera, mjetin kamion me vinc, me targë TR[***], me qera.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për mos plotësimin e kriterit në lidhje me mjetet e deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me dokumentet e mjeteve të dorëzuara përpara shpalljes fitues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit me anë të shkresës nr. 3105/8 prot., datë

21.11.2023 rezulton se operatori ekonomik "ITE GROUP" SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor kontratë qiraje me nr. repertori [***], nr. koleksioni [***], datë 13.04.2022 për mjetin me targë TR[***], kamion, marka Mercedes Benz, tipi 650, kontratë qiraje nr. repertori [***], me nr. koleksioni [***], datë 03.08.2023 për mjetin me targë AB[***], mjet për transport malli, kamion, marka Man, Tipi H21, mjetin me targa AB [***], mjet për transport malli, kamion me vinç, marka Scania, Tipi R480, si dhe kontratën e qirasë me nr. repertori [***], nr. koleksioni [***], datë 03.08.2023 për mjetin me targë AB[***], marka mercedes benz, tipi 19-22, kamion, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur për mjetet e sipërpërmendura.

Sa më sipër cituar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar ka provuar që disponon mjetet e deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sa i përket verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "ITE GROUP" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këtë pretendim, operatori ekonomik ankimues, nuk parashton fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me verifikimin e mjeteve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me dokumentet e mjeteve të dorëzuara duke mos paraqitur prova apo fakte dhe duke mos qënë i qartë se çfarë pretendimesh ngre. Akoma më tej, Komisioni gjykon se kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qënë i gabuar, sipas ankimuesit. Akoma më tej Komisioni gjykon se, refuar nenit 124 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "INPLY" SHPK nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e BOE "INPLY" SHPK & "Luar Bross" SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "ITE Group" SHPK me argumentin, se: "*...kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojë nëse ky operator ekonomik ka paraqitur të 3 kopjet e bilanceve të certifikuara të viteve (2020, 2021,2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore si dhe nëse këto bilance janë të shoqëruara me raportet e auditimit ligjor të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Nga verifikimet tona në faqet e intërnitetit ku pasqyrohen të dhëna mbi operatorët ekonomikë rezulton se ky operator nuk e ka të afishuar bilancin e vitit 2022. Si rrjedhojë ngremë dyshimet tona nëse ky operator e ka të certifikuar nga organet tatimore dhe të audituar nga ekspertë kontabël bilancin e vitit 2022 dhe të viteve të mëparshme*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në shtojcën 7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pika 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.3.2 Në përmbushje të pikës 2.2.2 të kriterëve të veçantat të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ka dorëzuar:

- Vërtetim nr. 675 prot., datë 20.08.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve
- Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, me raportin e Audituesit të Pavarur
- Vërtetim nr. 517 prot., datë 28.04.2021 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve
- Pasqyrat financiare 2020 + deklarate e hartuesit të pasqyrave financiare
- Vërtetim nr. 517 prot., datë 23.05.2022 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve
- Pasqyrat Financiare 2021+ raporti i audituesit të pavarur
- Pasqyra financiare për vitin 2022 + raporti i audituesit të pavarur

III.3.2. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. *Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.4. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”

III.2.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, edhe kopje të certifikuara të bilanceve të viteve (2020,2021,2022), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "ITE GROUP" SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Vërtetim nr. 675 prot., datë 20.08.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve, Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, me raportin e Audituesit të Pavarur, Vërtetim nr. 517 prot., datë 28.04.2021 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve, Pasqyrat financiare 2020, Vërtetim nr. 517 prot., datë 23.05.2022 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve, Pasqyrat Financiare 2021, raporti i audituesit të pavarur, Pasqyra financiare për vitin 2022, raporti i audituesit të pavarur. Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanat të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues "INPLY" SHPK, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", nuk ka një koncept të certifikimit të bilanceve, nga organet tatimore në kuptim të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", për rrjedhojë nuk ka një akt që mund të kërkohej apo të dorëzohet, ndërkohë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar ku parashikohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. "Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë", autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit

ekonomik. Akoma më tej Komisioni gjykon se autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë mund të kërkojë paraqitjen e dokumentave sipas përcaktimit të nenit 43 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Inply” SHPK nuk qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimin e BOE “INPLY” SHPK & “Luar Bross” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ITE Group” SHPK me argumentin, se: *“Kërkojmë nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe/ose Komisionit të Prokurimit Publik të verifikojë nëse ky operator ekonomik ka paraqitur vërtetime për furnizime të mëparshme të lëshuara nga ente publike për përmbushjen me sukses të kontratës/kontratave dhe/ose faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Ngremë dyshimet tona se ky operator ekonomik nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanata të kësaj procedure prokurimi pasi besojmë se nuk ka paraqitur fatura të mjaftueshme me subjekte private dhe/ose nuk ka paraqitur vërtetimet nga entet publike për realizimin me sukses të furnizimeve të ngjashme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 2.3.1 kapaciteti teknik përcaktohet se:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.4.2 Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “ITE GROUP” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Faturë tatimore shitje me nr.fature 4184/2023, datë 17.02.2023, me nr. 4457/2023, datë 21.02.2023, fature me nr. 17454/2023, datë 12.07.2023

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.4.5. Neni 40 pika 4 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.7. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin për të paraqitur dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të lotit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Referuar kriterit 2.3.1. në dokumentet e tenderit, për dëshmitë e kontrata të ngjashme, është kërkuar që "Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Komisioni mori në shqyrtim faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues: 4184/2023, datë 17.02.2023 ku është evidentuar specifikim i hollësishëm i artikullit të faturës nga ku rezulton se mallrat objekt i kësaj fature janë drozel 70 w, drozel 100w, injektor 70-400w, llampë CMH t 70w E27, llampë Led rrugore, llampë Led Power 50w, automat 1P 10A, puseta plastike+kapak, tub rigid, kanalinë metalike, tub flrksibël me dy shtresa, tub PVC D=200 mm, kapikorta, xhunto xhel 1.5-20/10mm kit etj, fatura nr. 4457/2023, datë 21.02.2023 mallrat objekt i kësaj kontrtae ndricues rrugor Led 7500 lumen, ndriçues rrugor LED 6300 lumen, , prozhektor LED, ndriçues + shtylle dekorative 3 degëssh, shtyllë metalike H=7.8 m+ kapak, Shtylle metalike H=5.5 m + kapak, konstruksione për shtylla betoni, etj., si dhe fatura 17454/2023 datë 12.07.2023 mallrat objekt i kësaj kontrate janë kamera IP Dinion starlight 8000 5 MP, lente montin C-mount 5mp 12-50 mm, krahe montimi mural bullet, ëorkstation hp, video regjistrator etj. Referuar objektit të kontratës “Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukurore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II”, Komisioni gjykon, se malli i përcaktuar në faturën 17454/2023, datë 12.08.2023 nuk është i ngjashëm me mallrat objekt-prokurimi dhe se nuk përmbush kriterin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me pajisje, jo të ngjashme me mallin objekt-prokurim. Komisioni gjykon se vlera e të dy faturave nr. 4184/2023, datë 17.02.2023 me vlerë 29 793 447,46 lekë, si dhe fatura 17454/2023 datë 12.07.2023 në vlerë 39 068 500.00 lekë pa TVSH =68,861,947.46, lekë pa TVSh më e madhe se vlera 40 % e fondit limit të lotit 66.666.666.8 lekë pa TVSh.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit në lidhje dëshmitë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës nga autoriteti kontraktor, qoftë me një ent publik apo sektorin privat.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INPLY” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “INPLY” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë*”, me Nr. REF-74538-07-07-2023 me objekt: “Loti 2: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale elektrike lëndë e parë Faza II”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 Lek pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,582,178.34 Euro, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INPLY” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri